



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
Prishtinë - Prishtina

---

## KOLEGJI "PJETER BUDI" - PRISTINË

**RREGULLORE PËR PAGA DHE ORARIN E PUNËS  
PËR PERSONELIN AKADEMIK**

**Prishtinë, 2020**



Në bazë të nenit 20 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi, Bordi Drejtues i Kolegjit me datë 25.12.2020, miratoi këtë:

## **RREGULLOREN PËR PAGA DHE ORARIN E PUNËS PËR PERSONELIN AKADEMIK**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet ndarja dhe realizimi i të ardhurave personale – pagës dhe orari i punës për personelin akademik të punësuar në Kolegjin "Pjetër Budi" – Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji "Pjetër Budi").

#### Neni 2

Të ardhurat personale – paga për personelin akademik të Kolegjit "Pjetër Budi", përcaktohet në bazë të punësimit të tij si personel i rregullt akademik apo personel i angazhuar.

#### Neni 3

Mjetet financiare për pagesën e të ardhurave personale, përcaktohen me planin financiar të Kolegji "Pjetër Budi".

### **II. TË ARDHURAT PERSONALE - PAGA**

#### Neni 4

E drejta në të ardhura personale – pagë, i takon të gjithë personave të punësuar si personel akademik, e të cilët kanë vendimin për emërim dhe kanë të nënshkruar kontratën e punës me Kolegjin "Pjetër Budi".

#### Neni 5

Personeli i rregullt akademik punon me orar të plotë të punës, ndërsa personeli i angazhuar, punon në bazë të nevojave dhe arsyes së angazhimit të tij në punë.

#### Neni 6

6.1. Të punësuarve me rastin e pagesës së pagës, duhet t'i dorëzohet llogaria me shkrim, e cila përmban së paku këto shënime:

---



- 6.1.1 pagën bruto dhe neto të punëtorit;
- 6.1.2 shtesat në pagë nëse ka;
- 6.1.3 pagesat e kontributeve dhe tatimeve për të ardhurat personale.

#### Neni 7

- 7.1. Të ardhurat personale jepen në fund të muajit, e më së largu gjer me datën 05 të muajit vijues dhe i paguhet të punësuarit;
  - 7.1.1. përmes transferit bankar në llogarinë e të punësuarit;
  - 7.1.2. personalisht të shoqëruara me dëftesën e pagesës.

### III. ORARI I PUNËS

#### Neni 8

- 8.1. Norma e plotë e orarit të punës për personelin e rregullt akademik, përcaktohet në bazë të këtyre kriterëve:
  - 8.1.1. Profesorët e rregullt, 5 orë në javë.
  - 8.1.2. Profesoret e asocuar, 5 ore ne javë.
  - 8.1.3. Profesorët asistentë, 6 ore ne javë.
  - 8.1.4. Ligjëruesit, 6 orë në javë.
  - 8.1.5. Asistentët e rregullt, 8 orë në javë.

Profesori i rregullt dhe profesori i asocuar për të mbajtur 1 orë ligjërata nevojitet të përgatitet 7 orë d.m.th.  $1+7=8$ .  $5 \times 8=40$  orë në javë. Pra, personeli i rregullt akademik – profesori i rregullt dhe profesori i asocuar i kanë 40 orë në javë.

Ligjëruesi për të mbajtur 1 orë ligjërata nevojitet të përgatitet 5.7 orë d.m.th.  $1+5.7=6.67$ .  $6 \times 6.7=40$  orë në javë. Pra, personeli i rregullt akademik – ligjëruesi i ka 40 orë në javë.

Profesori asistent për të mbajtur 1 orë ligjërata nevojitet të përgatitet 5.7 orë d.m.th.  $1+5.7=6.67$ .  $6 \times 6.7=40$  orë në javë. Pra, personeli i rregullt akademik – profesori asistent i ka 40 orë në javë.

Asistenti i rregullt për të mbajtur 1 orë ligjërata nevojitet të përgatitet 4 orë d.m.th.  $1+4=5$ .  $8 \times 5=40$  orë në javë. Pra, personeli i rregullt akademik – asistenti ka 40 orë në javë.

#### Neni 9

9.1. Për personelin e rregullt akademik, për normë të plotë të punës, paga dhe kompensimet janë si vijon:

- 9.1.1. Profesorët e rregullt, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).
- 9.1.2. Profesoret e asocuar, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).
- 9.1.3. Profesorët asistentë, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).
- 9.1.4. Ligjëruesit, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).



9.1.5. Asistentë të rregullt, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

Neni 10

10.1. Personeli i rregullt akademik, nëse e kalon normën e plotë të orarit të punës, për çdo orë shtesë, pagesa është si vijon:

9.1.6. Profesorë të rregullt, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

9.1.7. Profesorët e asocuar, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

9.1.8. Profesorët asistentë, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

9.1.9. Ligjëruesit, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

9.1.10. Asistentë të rregullt, \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

Neni 11

Për personelin e rregullt akademik, të emëruar në pozitat udhëheqëse, përveç pagës bazë, i takon edhe paga shtesë në vlerën prej \_\_\_\_\_ €.

Neni 12

Orari i punës për personelin e angazhuar, nënkupton se i punësuar është i obliguar të gjendet në vendin e punës gjatë orëve të ligjëratave, konsultimeve, organizimit të kollokuiumeve dhe të provimeve për lëndët në të cilat është i angazhuar.

Neni 13

Personelit akademik të angazhuar i takon paga në bazë të numrit të orëve të mbajtura brenda një muaji. Pagesa për një orë është: \_\_\_\_\_ € (me fjalë: \_\_\_\_\_).

#### IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurës së njëjtë me të cilën është miratuar.

Kjo rregullore e re shfuqizon rregulloren e vjetër për paga dhe orarin e punës të personelit akademik.

Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Presidenti i Bordit të Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Presidenti i Bordit Drejtues  
Besim AJETI